

REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA  
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI

Nr/Br. 850/20  
Datë/Datum. 23.10.20

PRISHTINË - PRIŠTINA

## ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: KRM ÇABRATI GJAKOVË

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: KPMC-20-5508-1-2-1

Sa i përket tenderit për Furnizim me goma dhe akumulator

## ANKESË

### 1. Identifikimi i ankuesit\*

HAXHIJAH TRADE SHPK

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

RR.XHELAL HAJDA NR.170

(Adresa)

RAHOVEC

(Vendi)

21010

(Kodi postar)

038 767 111

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

XHAN HAXHIJAH

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

info@haxhijahtrade.com

(Adresa elektronike)

23.10.2020

(Data e parashtrimit të ankesës)



\*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

### 2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

N/A  
(Emri i avokatit)

\_\_\_\_\_  
(Adresa e plotë)

\_\_\_\_\_  
(Numri i Telefonit)

\_\_\_\_\_  
(Numri i faks-it)

\_\_\_\_\_  
(Adresa elektronike)

\_\_\_\_\_  
(Data e parashtrimit të ankesës)

\_\_\_\_\_  
(Nënshkrimi dhe vula)

### 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar "Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Aktiviteti i prokurimit Njoftim për Kontratë është publikuar më datën 21.09.2020 në faqën e KRPP Afati i dorëzimit dhe hapja e tenderave ka qenë 01.10.2020

### 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☒

Jo ☐

Përmes e-prokurimit

### 5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

## 6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Më datën 14.10.2020 kemi pranuar vendimin e AK Çabratit për eliminim, (material i bashkëngjitur)

Më datën 14.10.2020 kemi parashtrur kërkesën për rishqyrtimin e vendimit tek AK Çabratit (materiali i bashkëngjitur)

Më datën 15.10.2020 kemi pranuar vendimin mbi pezullimin e aktivitetit të prokurimit (materiali i bashkëngjitur)

Më datën 19.10.2020 kemi pranuar vendimin e AK mbi refuzimin e kërkesës tonë për rishqyrtimin e vendimit (material i bashkëngjitur)

## 7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

**Shkelja e Nenit 60 pika 1,1 : TENDERUESI QË KA DORËZUAR TENDER TË PËRGJEGJSHËM ME ÇMIM MË TË ULËT;**

**Shkelja e Nenit 7, pika 1, 2, dhe 3 : BARAZIA NË TRAJTIM/JO-DISKRIMINIMI**

**Shkelja e Nenit 51, pika 1, 2 dhe 3 : NJOFTIM I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES**

**Shkelja e Nenit 52, pika 1 dhe 2 : NJOFTIM I KRITEREVE PËR DHËNIEN E KONTRATËS**

**\*\* Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.**

## 8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.



Haxhijaha Trade shpk për procedurën e Prokurimit KPMC-20-5508-1-2-1, Furnizim me goma dhe Akumulatora të datës 01.10.2020 ka ofruar çmimin e Tenderit 24.711,10 Euro, ndërsa Tenderuesi i dytë ka ofruar çmimin e Tenderit 25.757,12 Euro. Në këtë procedurë të prokurimit **KRITERI PËR DHËNIEN E KONTRATËS KA QENË ÇMIMI MË I ULËT** dhe në këtë rast Haxhijaha Trade shpk ka ofruar çmimin më të ulët dhe ka qenë e përgjegjshme.

Pretendimet tona ankimore parashtrohen për arsye se AK Çabrati ka refuzuar ofertën tonë, pranë faktit që oferta jonë ka qenë me çmimin më të ulët dhe ka qenë plotësisht e përgjegjshme, duke marrë vendimin për ta shpërbly tenderuesin që ka ofruar çmimin më të lartë në vlerë 25.757,12 Euro. AK Çabrati këtë vendim të tyre e kanë arsyetuar se Haxhijaha Trade ka ofruar 4 artikuj (nga gjithsej 42) me numër rendor 24, 25, 26 dhe 27 me çmimin më të lartë.

Ne e kemi dhënë sqarimin për këta katër artikuj (pikja, ngjitja, montimi - çmontimi i gomave të SKIP-it). Puna mbi pikjen e gomave të SKIP-it, kërkon angazhimin e fuqisë shtesë punëtore si dhe kohë më shumë gjatë montimit dhe çmontimit për shkak të natyrës së punës, peshës së gomave dhe kompleksit të punës në këto goma gjatë montim-çmontimit, përderisa dallon rasti i pikjes së gomave për vetura, sikurse që dallon edhe çmimi në ofertën tonë në krahasim me çmimet e SKIP-it.

Së dyti, AK Çabrati nuk ka kërkuar **peshimin e çmimit të artikujve**, me çka konsiderojmë se AK ka dalë jashtë kornizave të parashtuara në këtë procedurë të prokurimit.

Së treti, çmimet tona të ofruara janë në korelacion me çmimet aktuale të tregut të sotshëm, dhe referimet viteve paraprake, 2013 ...etj nuk mund të përputhen me rrethanat e sotme.

Refuzimi i ofertës tonë bie ndesh me Nenin 60 pika 1,1 **Kriter për dhënie e Kontratës çmimi më i ulët**. Në këtë procedurë nuk është kërkuar kriteri për dhënie e kontratës ekonomikisht më i favorshëm konform Nenit 60 1,2 por është kërkuar kriteri për dhënie e Kontratës çmimi më i ulët konform Nenit 60 1,1.

Refuzimi i ofertës tonë bie ndesh me Nenin 7 pika 1, 2, 3 **BARAZIMI NË TRAJTIM**.. si edhe neneve që i kemi përmendur më lartë.

#### **KERKESA**

Konform Parimeve themelore mbi Ankesat, sipas Nenit 104 pika 1, 2, 3 dhe 4 Haxhijaha Trade shpk kërkon:

Bazuar në shpjegimet e parashtuara si edhe materialit të bashkëngjitur, Të **APROVOHET** e **BAZUAR** kërkesa jonë kundër AK Çabrati dhe të kthehet vendimi për shpërblyimin e Tenderusit të dytë, dhe nga ana tjetër Ne - Haxhijaha Trade shpk të shpërblehemi me kontratë.

Me nderime  
Xhan Haxhijaha

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.*

**Dëmet materiale që do të na shkaktohen nëse nuk e marrim këtë kontratë janë të konsiderueshme, si: në fushën financiare, fitime të munguara, rishikim të stafit të angazhuar dhe mosmundësi e kompensimit të shpenzimeve pregaditore për këtë kontratë. Poashtu kemi edhe dëmtim të reputacionit si ndërmarrje furnizuese me një përvojë të madhe të furnizimit me goma.**

**Këto, sepse pas publikimit të tendetit, ne si OE i kemi bërë të gjitha përgaditje teknike dhe profesionale për të gjithë periudhën e paraparë të njoftimit për kontratë dhe në dosje të tenderit.**

#### **10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura**

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:*

- a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

*\*\*\*Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*